BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Analizë mbi Përdorimin e Instrumenteve të Pagesave

Mars 2017

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA

CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Analizë mbi Përdorimin e Instrumenteve të Pagesave

(bazuar në të dhënat e raportuara nga bankat komerciale në baza të rregullta periodike)

BOTUES ©Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Departamenti i Sistemit të Pagesave
33 Garibaldi, Prishtinë 10000
Tel: ++381 38 222 055
Fax: ++381 38 243 763

FAQJA E INTERNETIT www.bqk-kos.org

ADRESA ELEKTRONIKE payment.systems@bqk-kos.org

Gjylfidane Kastrati-Kadrijaj, Drejtore e Departamentit të Sistemit të Pagesave
Masar Baxhaku, Analist për Mbikëqyrje të Sistemit të Pagesave
Qëndresa Krasniqi, Zyrtare për Mbikëqyrje të Sistemit të Pagesave

SHKURTESAT:

ACH	Automatic Clearing House (Sistemi Automatik i Kliringut)
ATM	Bankomat
ATS	Automatic Transfer System (Sistemi Automatik i Transferit)
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
DD	Debitim Direkt
DSP	Departamenti i Sistemit të Pagesave
EFT-POS	Transferimi Elektronik i Mjeteve në Pikat e Shitjes
POS	Pikë e Shitjes
RTGS	Real Time Gross Settlement (Shlyerjet Bruto në Kohë Reale)
SEKN	Sistemi Elektronik i Kliringut Ndërbankar
SPN	Sistemi i Pagesave Ndërbankare

INFORMATË:

Për përshkrim më të detajuar referohuni shënimeve sqaruese.
Përdoruesit e këtyre të dhënave kërkohen të citojnë burimin.
Citimi i sugjeruar: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës,
Analizë mbi Përdorimin e Instrumenteve të Pagesave, Prishtinë 2016.
Çdo korrigjim i nevojshëm bëhet në versionin elektronik.
Ky publikim përfshin të dhënat në dispozicion deri më 31 dhjetor 2016.

PËRMBAJTJA

HYRJE ---------- **06**

1. Transaksionet ndërbankare ---------- **07**

1.1. Vëllimi dhe vlera e transaksioneve ndërbankare ---------- **07**

2. Numri i llogarive bankare ---------- **11**

2.1. Llogaritë e-banking ---------- **12**

2.2. Urdhëresat periodike ---------- **15**

2.3. Debitimi Direkt ---------- **15**

3. Terminalet ATM dhe POS ---------- **16**

4. Numri i kartelave ---------- **18**

5. Transaksionet me kartela ---------- **19**

PREZANTIMI GRAFIK

1. Përqindja e transaksioneve (sipas numrit) ---------- 09
2. Përqindja e transaksioneve (sipas vlerës) ---------- 09
3. Numri i transaksioneve të rregullta (në milionë) ---------- 10
4. Vlera e transaksioneve të rregullta (në miliardë euro) ---------- 10
5. Numri i transaksioneve ndërbankare (në milionë) ---------- 10
6. Vlera e transaksioneve ndërbankare (në miliardë euro) ---------- 10
7. Numri i llogarive bankare (në milionë) ---------- 11
8. Numri i llogarive e-banking ---------- 13
9. Numri i transaksioneve e-banking (në mijëra) ---------- 14
10. Vlera e transaksioneve e-banking (në miliardë) ---------- 14
11. Urdhëresat periodike ---------- 15
12. Debitimi Direkt ---------- 16
13. Numri i terminaleve POS ---------- 17
14. Debit dhe kredit kartelat ---------- 19
15. Numri i përgjithshëm i kartelave ---------- 19

TABELAT STATISTIKORE

1. Numri i transaksioneve ndërbankare ---------- 08
2. Vlera e transaksioneve ndërbankare ---------- 08

3. Numri i llogarive bankare ---------- 11
4. Numri i llogarive e-banking sipas llojit ---------- 14
5. Numri i terminaleve ATM ---------- 17
6. Numri i terminaleve POS ---------- 17
7. Numri i kartelave sipas funksionit ---------- 18
8. Numri i transaksioneve me kartela ---------- 20
9. Vlera e transaksioneve me kartela ---------- 21

Përfundim ---------- 22

Hyrje

Sistemet e pagesave të sigurta dhe efikase janë faktor i rëndësishëm për stabilitetin financiar dhe zhvillimin ekonomik të një vendi. Objektivi parësorë i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës është "nxitja dhe ruajtja e një sistemi të qëndrueshëm financiar si dhe një sistemi efikas të pagesave".

Në këtë kuadër, sigurimi i funksionimit normal të sistemeve të pagesave është një nga objektivat dhe detyrat kryesore të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Sistemi i pagesave në Kosovë edhe gjatë kësaj periudhe ka vazhduar të operojë me shkallë të lartë të efikasitetit dhe të sigurisë, duke mundësuar kliringun dhe shlyerjen e pagesave dhe të letrave me vlerë në përputhje me rregullat dhe standardet në fuqi.

Pjesë e rëndësishme e sistemeve të pagesave janë instrumentet e pagesave, të cilët u mundësojnë klientëve transferin e fondeve mes llogarive në banka apo edhe në institucione tjera financiare. Instrumentet e pagesave pa para të gatshme të cilët përdoren në Kosovë janë: transferet e kreditit, kartelat për pagesa (debit dhe kredit), si dhe debitimi direkt. Siguria dhe efikasiteti i këtyre instrumenteve të pagesave janë të rëndësishme në mbajtjen e besimit në to si dhe në zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë.

Tremujori i katërt i vitit 2016 është karakterizuar me rritje si në numër ashtu edhe në përdorim të instrumenteve të pagesave pa para të gatshme.

Inkurajues është fakti se krahas rritjes së numrit të instrumenteve për pagesa elektronike, gjatë tremujorit të katërt të vitit 2016 vërehet një rritje e shpejtë edhe e përdorimit të këtyre instrumenteve.

1. Transaksionet ndërbankare

Gjatë tremujorit të kaluar (TM3 2016), Banka Qendrore e Kosovës ka implementuar sistemin e ri të pagesave ndërbankare i cili ka zëvendësuar plotësisht sistemin e mëhershëm - Sistemin Elektronik të Kliringut Ndërbankar (SEKN).

Sistemi i ri i pagesave ndërbankare, i quajtur ATS (automatic transfer system/sistemi automatik i transferit) përbëhet nga dy komponentë kryesor: komponenti i RTGS-së (Real Time Gross Settlement/shlyerjet bruto në kohë reale) i cili mundëson transferimin e fondeve në kohë reale, si dhe komponenti ACH (Automatic Clearing House/sistem automatik i kliringut) që bënë procesimin e pagesave në grup dhe me vlerë të vogël.

Në Sistemin e ri të Pagesave Ndërbankare (SPN), në përdorim që nga 01/07/2016, të gjitha transaksionet e pagesave ndërbankare me vlerë mbi 10,000 euro realizohen në kohë reale dhe sistemi i konsideron si pagesa prioritare. Pagesat nën këtë vlerë trajtohen si pagesa me vlerë të vogël dhe procesohen në grupe sipas sesioneve të caktuara, ndërsa shlyerja e tyre kryhet në baza neto pas çdo sesioni.

Pagesat bankë-bankë janë kategori e re e pagesave në SPN, ku përfshihen tërheqje dhe deponime të cash-it, transferet ndërkombëtare, kredi brenda ditore, tarifat, provizionet etj.

1.1. Vëllimi dhe vlera e transaksioneve ndërbankare

Nga të dhënat statistikore të analizuara në këtë raport, mund të konstatohet për rritjen e vazhdueshme të numrit të transaksioneve ndërbankare për secilin lloj të pagesave.

Pagesat e rregullta individuale të cilat procesohen përmes ACH-së kanë pasur një tendencë të qëndrueshme rritjeje nga viti në vit, gjë që ka ndikuar edhe në rritjen e përgjithshme të transaksioneve ndërbankare. Pagesat me vlerë të madhe (mbi 10,000 €) dhe ato prioritare, të cilat procesohen përmes komponentit RTGS në kohë reale dhe në baza bruto, gjithashtu kanë shënuar rritje të vazhdueshme në tremujorin e fundit të vitit 2016.

Pagesat Kos-Giro, fillimisht ishin të pranuara nga një numër i limituar i kompanive. Megjithatë me kalimin e kohës numri i kompanive që përdornin Kos-Giro u rrit, gjë që ndikoi edhe në rritjen e numrit dhe vlerës së transaksioneve Kos-Giro. Sot këto transaksione përfaqësojnë një pjesë shumë të rëndësishme të sistemit të pagesave.

Në tabelën 1 është paraqitur numri i transaksioneve ndërbankare për secilin modul të pagesave, që nga viti 2012 deri në vitin 2016.

Tabela 1. Numri i transaksioneve ndërbankare

Lloji i pagesave		2012	2013	2014	2015	2016
Pagesat RTGS	Pagesa të klientëve	22,300	24,812	26,079	28,645	64,762
	Pagesa bankë-bankë	n/a	n/a	n/a	n/a	3,194
	Letra me Vlerë	309	498	618	976	1,433
Pagesat ACH	Pagesa Normale	833,409	970,717	1,032,043	1,210,355	1,303,683
	Pagesa Masive	2,916,145	3,294,677	3,731,436	3,766,942	4,087,636
	Pagesa Kos Giro	543,338	692,281	1,013,620	1,349,316	1,413,616
	Pagesa Paga/Pensione	3,873	1,797,330	3,233,049	3,463,257	4,686,475
	Pagesa Debitim Direkt	10,304	13,115	14,582	15,565	26,610
	Pagesa të kthyera				2,921	9,646
Gjithsej		4,329,678	6,793,430	9,051,427	9,837,977	11,597,055

Burimi: BQK (2016)

Numri i përgjithshëm i transaksioneve ndërbankare gjatë vitit 2016 arriti në rreth 11.59 milionë transaksione. Faktori kryesor që ka ndikuar në rritjen e numrit të transaksioneve ndërbankare të SPN-së gjatë kësaj periudhe është procesimi i pagave të shërbyesve të administratës publike, si dhe pagesave për kategoritë e skemave sociale të MPMS-së përmes këtij sistemi. Po ashtu, edhe rimbursimi i kuponëve fiskal nga ana e Ministrisë së Financave ka ndikuar në rritjen e transaksioneve ndërbankare përmes SPN-së.

Pagesat e rregullta individuale gjatë vitit 2016 vazhduan me trend rritës, numri i tyre kaloi mbi 1.3 milionë transaksione. Me trend të rritjes u karakterizuan edhe llojet e tjera të transaksioneve: numri i pagesave të klientëve përmes komponentit RTGS arriti në 64.8 mijë transaksione, të rregullta masive mbi 4.1 milionë transaksione, Kos Giro mbi 1.4 milionë transaksione, Debitimi Direkt mbi 26.6 mijë transaksione, të cilat gjithnjë e më shumë po bëhen pjesë e rëndësishme e SPN-së.

Tabela 2. Vlera e transaksioneve ndërbankare

Lloji i pagesave		2012	2013	2014	2015	2016
Pagesat RTGS	Pagesa të klientëve	893,490,615	768,577,986	666,722,026	712,772,611	2,239,927,676
	Pagesa bankë-bankë	n/a	n/a	n/a	n/a	2,430,737,860
	Letra me Vlerë	252,653,198	534,011,408	695,370,096	723,042,066	910,474,588
Pagesat ACH	Pagesa Normale	3,161,880,010	3,319,527,253	3,329,886,961	3,677,815,746	2,416,603,204
	Pagesa Masive	470,361,458	531,795,573	536,499,429	595,030,788	658,485,414
	Pagesa Kos Giro	892,130,913	899,986,956	949,316,256	1,048,213,712	1,145,873,024
	Pagesa Paga/Pensione	2,397,909	374,517,269	645,334,638	707,508,538	838,453,497
	Pagesa Debitim Direkt	8,043,429	6,763,903	7,182,931	7,152,037	8,568,652
	Pagesa të kthyera				4,049,827	4,737,342
Gjithsej		5,680,957,532	6,435,180,348	6,830,312,337	7,475,585,325	10,653,861,257

Burimi: BQK (2016)

Në tabelën 2 është paraqitur vlera e transaksioneve ndërbankare nga viti 2012 deri vitin 2016. Vlera e përgjithshme e transaksioneve ndërbankare gjatë këtij viti arriti vlerën e rreth 10.65 miliardë euro. Vetëm vlera e pagesave të rregullta individuale kaloi vlerën e 2,4 miliardë euro, ndërsa vlera e moduleve tjera të pagesave ishte më e vogël krahasuar me pagesat e rregullta.

Duke u bazuar në të dhënat e paraqitura në tabelën 1 dhe 2, mund të konstatohet lidhur me peshën e secilit lloj të pagesave në vlerën e përgjithshme të pagesave.

Gjatë vitit 2016, pagesat e rregullta individuale të cilat procesohen përmes komponentit ACH përbëjnë 11.24 përqind të numrit të përgjithshëm të pagesave ndërsa në vlerën e përgjithshme të transaksioneve ndërbankare ato marrin pjesë me 22.68 përqind. Pagesat me vlerë të madhe dhe ato prioritare (të iniciuara nga klientët)të cilat procesohen përmes komponentit RTGS zënë vetëm 0.56 përqind të numrit të transaksioneve, ndërsa vlera e tyre përbën rreth 21.02 përqind të vlerës së transaksioneve.

Figura 1. Përqindja e transaksioneve (sipas numrit)



Burimi: BQK (2016)

Figura 2. Përqindja e transaksioneve (sipas vlerës)



Burimi: BQK (2016)

Pagesat e rregullta masive përbëjnë rreth 35.25 përqind të numrit të përgjithshëm të transaksioneve ndërsa vlera e tyre merr pjesë me 6.18 përqind në vlerën e transaksioneve. Pagesat e procesuara përmes modulit të pagesave për paga dhe pensione përbëjnë rreth 40.41 përqind të numrit të përgjithshëm të transaksioneve ndërbankare ndërsa vlera e tyre rreth 7.87 përqind të vlerës së transaksioneve ndërbankare. Debitimi Direkt merr pjesë me më pak se 1%, si në numër ashtu edhe në vlerë të transaksioneve ndërbankare.

Pagesat Kos Giro vazhdojnë të jenë pjesë shumë e rëndësishme e sistemit të pagesave: numri i tyre përbën 12.19 përqind të numrit të transaksioneve, ndërsa vlera e tyre përbën 10.76 përqind të vlerës së transaksioneve ndërbankare. Letrat me vlerë marrin pjesë me numër shumë të vogël (rreth 0.01 përqind), por vlera e tyre përbën rreth 8.55 përqind të vlerës së përgjithshme të transaksioneve ndërbankare.

Figura 3. Numri i transaksioneve të rregullta (në milionë)



Burimi: BQK (2016)

Figura 4. Vlera e transaksioneve të rregullta (në miliardë euro)



Burimi: BQK (2016)

Në figurat 3 dhe 4 janë paraqitur numri dhe vlera e pagesave të rregullta individuale dhe të rregullta masive nga viti 2012 deri në vitin 2016. Nga të dhënat e paraqitura në figura, më së miri shihet dallimi mes numrit dhe vlerës së këtyre transaksioneve. Përderisa pagesat e rregullta masive dominojnë në numër ndaj atyre të rregullta individuale, e kundërta mund të thuhet për vlerën e tyre.

Figura 5. Numri i transaksioneve ndërbankare (në milionë)



Burimi: BQK (2016)

Figura 6. Vlera e transaksioneve ndërbankare (në miliardë euro)



Burimi: BQK (2016)

Në figurat 5 dhe 6 është paraqitur numri dhe vlera e përgjithshme e transaksioneve ndërbankare nga viti 2012 deri në vitin 2016. Si rezultat i funksionimit efikas dhe të sigurt të sistemit të pagesave në Kosovë, numri dhe vlera e pagesave ndërbankare vazhdimisht është në rritje.

2. Numri i llogarive bankare

Shtrirja gjeografike e bankave komerciale në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës ka ndikuar që qytetarët të kenë më të lehtë qasjen në banka dhe rrjedhimisht pjesa më e madhe e popullatës është e përfshirë në një mënyrë apo tjetër në marrëdhënie me banka (p.sh. kanë llogari bankare, kartela, kredi etj.).

Në fund të tremujorit të katërt të vitit 2016, numri i llogarive bankare në Kosovë ishte rreth 1.88 milion llogari, që në krahasim me numrin e popullsisë do të thotë se afërsisht çdo banor ka një llogari bankare.

Tabela 3. Numri i llogarive bankare

Përshkrimi i llogarive	2015				2016			
	TM1	TM2	TM3	TM4	TM1	TM2	TM3	TM4
Llogaritë e klientëve	1,955,723	1,873,685	1,886,277	1,886,644	1,909,577	1,940,745	1,966,070	1,875,091
1 - llogari të rezidentëve	1,925,017	1,845,588	1,858,131	1,858,676	1,881,074	1,911,137	1,935,943	1,846,108
a - individuale	1,795,369	1,717,378	1,731,360	1,732,544	1,754,093	1,781,510	1,805,458	1,714,159
b - afariste	129,648	128,210	126,771	126,132	126,981	129,627	130,485	131,949
2 - llogari të jorezidentëve.	30,706	28,097	28,146	27,968	28,503	29,608	30,127	28,983
a - individuale	29,645	27,047	27,213	27,085	27,640	28,761	29,283	28,112
b - afariste	1,061	1,050	933	883	863	847	844	871

Burimi: BQK (2016)

Në tabelën 3 është paraqitur numri i llogarive bankare gjatë 2 viteve të fundit të ndara sipas mbajtësve të llogarive. Në TM4 të vitit 2016 numri i përgjithshëm i llogarive bankare është 1,875,091 nga të cilat 98,5 përqind janë llogari të rezidentëve, ndërsa vetëm rreth 1.5 përqind janë llogari të jorezidentëve. Në krahasim me tremujorin e kaluar, numri i llogarive ka rënë për rreth 4.63 përqind. Nëse krahasimin e bëjmë me periudhën e njëjtë të një viti më parë, do të vërejmë se numri i përgjithshëm i llogarive ka rënë për rreth 0.6 përqind.

Numri kaq i lartë i llogarive bankare mund të shpjegohet me faktin se një klient mund të ketë llogari në më shumë se një bankë në të njëjtën kohë.

Figura 7. Numri i llogarive bankare (në milionë)



Burimi: BQK (2016)

2.1. Llogaritë e-banking

Përkundër trendit në rritje, megjithatë Kosova vazhdon të ketë numër relativisht të vogël të përdoruesve të shërbimit e-banking. Në figurën 8 është paraqitur numri i përdoruesve të këtij shërbimi sipas viteve. Në vitin 2014 numri i llogarive, që klientët mund t'iu qasen përmes internetit pati trend rritës rreth 20.1 përqind krahasuar me fundin e vitit 2013. Krahasuar me

vitin 2014, në vitin 2015 numri i llogarive që klientët mund t'u qasen on-line nga interneti u rrit për 18.7 përqind.

Në fund të tremujorit të katërt të vitit 2016 numri i llogarive të cilave klientët mund t'iu qasen përmes internetit arriti në 230,905 që krahasuar me vitin 2015 paraqet rritje prej rreth 23.3 përqind.

Rritja e numrit të përdoruesve të shërbimit e-banking zvogëlon në masë të madhe edhe pagesat në para të gatshme, i cili është edhe njëri nga qëllimet e institucioneve financiare në vend. Kryerja e transaksioneve përmes shërbimit e-banking është një formë mjaft efikase dhe e sigurt, pasi që klientët kursejnë kohë dhe transaksionet mund t'i kryejnë në çdo kohë dhe nga çdo vend.

Figura 8. Numri i llogarive e-banking



Burimi: BQK (2016)

Në tabelën 4 është paraqitur numri i llogarive të cilave klientët mund t'iu qasen përmes shërbimit e-banking sipas tipit të llogarive, të ndara në llogari të individëve dhe llogari afariste. Nga të dhënat e paraqitura në tabelë shihet se nga numri i përgjithshëm i llogarive e-banking, 79.93 përqind janë llogari që shfrytëzohen nga personat privatë, ndërsa vetëm 20.07 përqind janë llogari që shfrytëzohen nga ana e bizneseve.

Tabela 4. Numri i llogarive e-banking sipas llojit

Përshkrimi	Numri	%
Llogari individuale	184,573	79.93%
a - individuale (rezident)	180,042	
b - individuale (jo-rezident)	4,531	
Llogari afariste	46,332	20.07%
a - afariste (rezident)	45,913	
b - afariste (jo-rezident)	419	
Totali	230,905	100.00%

Burimi: BQK (2016)

Nga tabela po ashtu shihet se nga numri i përgjithshëm i llogarive individuale të cilave klientët mund t'iu qasen përmes shërbimin e-banking, 97.4 përqind e tyre janë llogari të rezidentëve, ndërsa vetëm rreth 2.6 përqind janë të jorezidentëve. E njëjta mund të thuhet edhe për llogaritë e personave juridikë, ku nga numri i përgjithshëm i tyre rreth 99 përqind janë të rezidentëve, ndërsa vetëm 1 përqind janë të jorezidentëve.

Në grafikun 9 dhe 10 është paraqitur numri dhe vlera e pagesave të procesuara përmes shërbimit e-banking. Nga të dhënat e paraqitura shihet rritja e shpejtë e numrit dhe vlerës së transaksioneve me e-banking.

Figura 9. Numri e transaksioneve e-banking (në mijëra)



Burimi: BQK (2016)

Figura 10. Vlera e transaksioneve e-banking (në miliardë)



Burimi: BQK (2016)

2.2. Urdhëresat Periodike

Numri i llogarive të lidhura me urdhëresa periodike vazhdimisht ka pasur ndryshime edhe pse këto ndryshime kanë qenë me ritëm mjaft të ulët. Nga figura 11 mund të shihet lëvizja e numrit të llogarive të lidhura me urdhëresa periodike sipas viteve. Nëse krahasojmë numrin e llogarive të lidhura me urdhëresa periodike mes vitit 2013 me fundin e vitit 2012, do të konstatohet se ka pasur normë rritëse rreth 10.8 përqind. Në fund të vitit 2015 numri i llogarive të lidhura me urdhëresa periodike pati ngritje për 8.1 përqind krahasuar me fundin e vitit 2014, ndërsa numri i llogarive të lidhura me urdhëresa periodike në fund të tremujorit të katërt të vitit 2016 arriti në 48,242.

Figura 11. Urdhëresat periodike



Burimi BQK (2016)

2.3. Debitimi Direkt

Njëra nga format e reja për kryerjen e disa shërbimeve të caktuara të pagesave është Debitimi Direkt, skemë kjo e operuar dhe mbikëqyrur nga BQK-ja. Nëse krahasojmë numrin e transaksioneve të Debitimit Direkt në tremujorin e katërt të vitit 2016 (TM4 2016) me tremujorin përkatës të vitit 2015, (TM4 2015) do të shohim se ka pasur ngritje prej rreth 81.90 përqind, ndërsa vlera e transaksioneve përmes skemës së Debitimit Direkt në këtë periudhë ka pasur rritje rreth 60.37 përqind.

Tabela 5. Numri dhe vlera e transaksioneve përmes Debitimit Direkt

Transaksionet ndërbankare të realizuara përmes skemës së Debitimit Direkt	Numër			Vlerë		
	TM4 2015	TM4 2016	Ndryshimi (%)	TM4 2015	TM4 2016	Ndryshimi (%)
	4,633	8,429	81.90%	1,834,060	2,941,248	60.37%

Burimi: BQK (2016)

3. Terminalet ATM dhe POS

Në tabelën 6 është paraqitur numri i terminaleve ATM nëpër vite nga viti 2012 deri në tremujorin e tretë të vitit 2016. Nga të dhënat e paraqitura në tabelë mund të vërehet rritja e numrit të terminaleve ATM përgjatë viteve. Numri i ATM-ve kishte normë rritëse për vitin 2012, nëse krahasojmë vitin 2012 me fundin e vitit 2011 do të konstatohet normë e rritjes prej rreth 5 përqind. Ndërsa gjatë vitit 2013, numri i terminaleve ATM është rritur rreth 2.7 përqind.

Në fund të vitit 2014 numri i terminaleve ATM arrin në 498, që krahasuar me një vit më parë paraqet rritje prej rreth 0.4 përqind. Numri i terminaleve ATM në fund të vitit 2015 ishte 540, që krahasuar me fundin e vitit 2014 paraqet rritje prej rreth 8.43 përqind, ndërsa në fund të tremujorit të katërt të vitit 2016 numri i terminaleve ATM shënoi rënie në 522 terminale.

Shumica e terminaleve ATM që janë instaluar në Kosovë ofrojnë funksionin e tërheqjes, ndërsa 121 prej tyre ofrojnë edhe mundësinë e deponimit.

Tabela 6. Numri i Terminaleve ATM

Terminalet sipas funksionit	2012	2013	2014	2015	2016
Automated Teller Machines (ATM)	483	496	498	540	522
prej të cilave:					
1 - ATM me funksion tërheqje cash	483	496	498	540	522
2 - ATM me funksion të pagesave Kos-Giro	73	70	50	97	131
3 - ATM me funksion depozitim cash	1	8	13	78	121

Burimi: BQK (2016)

Në grafikun 12 është paraqitur shpërndarja e rrjetit të terminaleve ATM në qytetet më të mëdha të Kosovës për tremujorin e tretë të vitit 2016. Nga grafiku konstatohet se pjesa më e madhe e terminaleve ATM është koncentruar në qytetin e Prishtinës, ndërsa pjesa tjetër është e shpërndarë mes qyteteve tjera të Kosovës. Arsyet e përqendrimit kaq të madh të terminaleve ATM në Prishtinë janë të ndryshme si: numri i madh i banorëve që jetojnë në Prishtinë, numri i filialeve të bankave, bizneset që operojnë në këtë qytet, etj.

Figura 12. Shpërndarja e terminaleve ATM nëpër qytete



Burimi: BQK (2016)

Në tabelën në vijim është paraqitur numri i terminaleve POS të instaluar në Kosovë nga viti 2012 deri në tremujorin e tretë të vitit 2016. Terminalët POS u mundësojnë klientëve kryerjen e pagesave me kartela pa pasur nevojë për para të gatshme. Kjo është një mënyrë shumë e lehtë dhe e sigurt e kryerjes së pagesave për mallra apo shërbime të ndryshme.

Në fund të vitit 2013 numri i terminaleve POS arriti në 9,071, që krahasuar me vitin 2012 paraqet rritje prej 5.6 përqind. Po ashtu edhe gjatë vitit 2014 numri i terminaleve POS vazhdoi të rritet, që krahasuar me fundin e vitit

2013 paraqet rritje prej rreth 3.1 përqind. Në vitin 2015 numri i terminaleve POS u rrit për 3.81 përqind krahasuar me vitin 2014.

Në TM4 2016 numri i terminaleve POS arriti në 10,589 që krahasuar me fundit e vitit 2015 paraqet rritje prej rreth 9.11 përqind.

Tabela 7. Numri i terminaleve POS

Terminalet sipas funksionit	2012	2013	2014	2015	2016
Terminale POS (Point of Sale)	8,592	9,071	9,349	9,705	10,589
prej të cilave:					
1 - terminale POS me funksion tërheqje cash	220	215	220	180	168
2 - terminale EFTPOS	8,499	8,856	9,179	9,525	10,421

Burimi: BQK (2016)

Në grafikun 13 është paraqitur shpërndarja e rrjetit të terminaleve POS në qytetet më të mëdha të Kosovës për tremujorin e tretë të vitit 2016. Ngjashëm me shpërndarjen e terminaleve ATM edhe rrjeti i terminaleve POS është më i përqendruar në Prishtinë.

Figura 13. Shpërndarja e terminaleve POS nëpër qytete



Burimi BQK (2016)

4. Numri i Kartelave

Në tabelën 8 është paraqitur numri i kartelave sipas funksionit që kryejnë, nga viti 2015 deri në tremujorin e katërt të vitit 2016. Në TM4 2016 numri i kartelave me funksion debiti shënoi rritje prej rreth 19.2 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, po ashtu edhe numri i kartelave të kreditit pati trend rritës prej rreth 8.74 përqind. Numri i përgjithshëm i kartelave në TM4 2016 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar pati rritje prej rreth 17.46 përqind.

Tabela 8. Numri i kartelave sipas funksionit [1]

Kartelat sipas funksionit	2015				2016			
	TM1	TM2	TM3	TM4	TM1	TM2	TM3	TM4
Kartela me funksion cash-i	802,861	796,299	838,817	862,779	907,384	954,475	988,519	1,013,155
Kartela me funksion pagese	801,516	796,122	838,619	862,580	907,185	954,268	988,519	1,013,155
prej të cilave:								
1 - Kartela me funksion debiti	666,965	658,885	696,640	718,717	760,578	804,862	837,894	856,718
2 - Kartela me funksion krediti	134,551	137,237	141,979	143,863	146,607	149,406	150,625	156,437
Kartela me funksion para elektronike	1,345	177	198	199	199	207	207	234
Numri total i kartelave	**802,861**	**796,299**	**838,817**	**862,779**	**907,384**	**954,475**	**988,726**	**1,013,389**

Burimi BQK (2016)

Në figurat 14 dhe 15 është paraqitur numri i kartelave të debitit dhe kreditit, si dhe numri i përgjithshëm i tyre për disa vite. Kartelat e debitit vazhdojnë edhe më tutje të mbeten në numër më të madh krahasuar me llojet e tjera të kartelave. Kështu në TM4 2016 kartelat e debitit përbënin rreth 84.5 përqind të numrit të përgjithshëm të kartelave, kartelat e kreditit merrnin pjesë me 15.5 përqind të numrit të përgjithshëm të kartelave.

Figura 14. Debit dhe kredit kartelat (në mijëra)



Burimi: BQK (2016)

Figura 15. Numri i përgjithshëm i kartelave (në mijëra)



Burimi: BQK (2016)

Në grafikun në vazhdim është paraqitur shpërndarja e kartelave sipas moshës së poseduesve të tyre. Nga të dhënat e paraqitura në grafik shihet se nga numri i përgjithshëm i poseduesve të kartelave, 14.57 përqind e tyre janë të moshës 18-25 vjeç, 23.43 përqind janë të moshës 26-35 vjeç, 21.47 përqind të moshës 36-45 vjeç, 17.30 përqind të moshës 46-55 vjeç dhe 23.23 përqind të moshës mbi 55 vjeç.

[1] Për vitin 2015 dhe për periudhën TM1 2016 janë bërë revidime të të dhënave për kartela sipas raporteve të përmirësuara nga disa banka raportuese.

Figura 16. Poseduesit e kartelave sipas moshës



Burimi: BQK (2016)

Në grafikun 17 është paraqitur struktura e mbajtësve të kartelave sipas gjinisë. Nga të dhënat e paraqitura në grafik, mund të konstatohet për shpërndarje joproporcionale të kartelave sipas gjinisë së poseduesve të tyre, me ç'rast, nga numri i përgjithshëm i kartelave, vetëm 31.12 përqind e tyre zotërohen nga femrat, ndërsa pjesa tjetër prej 68.88 përqind zotërohet nga meshkujt.

Figura 17. Poseduesit e kartelave sipas gjinisë



Burimi: BQK (2016)

5. Transaksionet me Kartela

Nga tabela numër 9 mund të shihet lëvizja e numrit të transaksioneve me kartela gjatë vitit 2014, 2015 dhe gjatë tremujorit të katërt të vitit 2016 sipas periudhave të rregullta tremujore. Nga të dhënat e paraqitura në tabelë, mund të konstatohet se numri i përgjithshëm i transaksioneve me kartela ka pasur rritje të vazhdueshme përgjatë çdo periudhe.

Në tremujorin e parë të vitit 2015 numri i transaksioneve me kartela u rrit për 7.69 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të një viti më parë. Numri

i tërheqjeve në terminalet ATM u rrit për 4.17 përqind, ndërsa numri i pagesave me kartela në terminale POS u rrit për 14.78 përqind.

Në tremujorin e tretë të vitit 2015 numri i transaksioneve me kartela u rrit për 6.1 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të një viti më parë. Numri i tërheqjeve në terminalet ATM u rrit për 0.25 përqind, ndërsa numri i pagesave me kartela në terminale POS u rrit për 15.2 përqind.

Në tremujorin e katërt të vitit 2015 numri i transaksioneve me kartela u rrit për 14.3 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të një viti më parë. Numri i tërheqjeve në terminalet ATM u rrit për 8.5 përqind, ndërsa numri i pagesave me kartela në terminale POS u rrit për 17.5 përqind.

Në tremujorin e parë të vitit 2016 numri i transaksioneve me kartela u rrit për 23.3 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të një viti më parë (TM1 2015). Numri i tërheqjeve në terminalet ATM u rrit për 15.3 përqind, ndërsa numri i pagesave me kartela në terminale POS u rrit për 27.4 përqind.

Në tremujorin e dytë të vitit 2016 numri i transaksioneve me kartela u rrit për 23.5 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të një viti më parë (TM2 2015). Numri i tërheqjeve në terminalet ATM u rrit për 14.9 përqind, ndërsa numri i pagesave me kartela në terminale POS u rrit për 29.34 përqind.

Në tremujorin e tretë të vitit 2016 numri i transaksioneve me kartela u rrit për 24.1 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të një viti më parë (TM3 2015). Numri i tërheqjeve në terminalet ATM u rrit për 19.5 përqind, ndërsa numri i pagesave me kartela në terminale POS u rrit për 23.1 përqind.

Në tremujorin e katërt të vitit 2016 numri i transaksioneve me kartela u rrit për 22.5 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të një viti më parë (TM4 2015). Numri i tërheqjeve në terminalet ATM u rrit për 21.4 përqind, ndërsa numri i pagesave me kartela në terminale POS u rrit për 19.3 përqind.

Tabela 9. Numri i transaksioneve me kartela

Përshkrimi	2015				2016			
	TM1	TM2	TM3	TM4	TM1	TM2	TM3	TM4
Numri i Transaksioneve	3,580,551	4,015,743	4,109,146	4,478,556	4,414,326	4,958,040	5,098,926	5,486,167
prej të cilave:								
1 - ATM tërheqje cash	2,339,230	2,656,966	2,647,602	2,778,819	2,697,961	3,052,950	3,162,793	3,372,854
2 - ATM depozitime	19,741	29,075	54,457	129,352	166,114	192,982	215,158	246,115
3 - Kredit transfere nëpërmjet ATM	11,608	10,875	10,166	9,923	8,535	8,641	8,676	7,854
4 - Tërheqje cash në terminale POS	1,778	2,762	7,286	2,697	2,207	1,302	1,364	614
5 - Pagesa me kartela në terminale POS	1,208,194	1,316,065	1,389,635	1,557,765	1,539,509	1,702,165	1,710,935	1,858,730

Burimi: BQK (2016)

Nga të dhënat e paraqitura në tabelën 9, shihet se tërheqjet në ATM përbëjnë pjesën më të madhe të transaksioneve me kartela. Në TM4 2016, tërheqjet në ATM përbënin rreth 61.48 përqind të numrit të përgjithshëm të transaksioneve me kartela, pagesat në POS terminale rreth 33.87 për qind, kredit transferet në ATM rreth 0.17 përqind, tërheqje në POS terminale 0.02 përqind dhe deponimet cash në ATM rreth 4.49 përqind të numrit të përgjithshëm të transaksioneve me kartela.

Në tabelën 10 është paraqitur vlera e transaksioneve me kartela gjatë vitit 2015 dhe vitit 2016 e ndarë sipas periudhave të raportimit. Nga të dhënat në tabelë, shihet se krahas rritjes së numrit të transaksioneve me kartela është rritur edhe vlera e përgjithshme e këtyre transaksioneve.

Krahasuar me periudhën e njëjtë të një viti më parë, në TM4 2016 shihet se vlera e përgjithshme e transaksioneve me kartela është rritur për rreth 31.42 përqind, vlera e tërheqjeve në ATM është ngritur për rreth 26.88 përqind, vlera e pagesave në POS terminale ka rënë për rreth 11.77 përqind, ndërsa depozitimi i parave përmes ATM terminaleve ka pasur ngritje dhe ka arritur vlerën e mbi 190 milionë euro.

Tabela 10. Vlera e transaksioneve me kartela

Përshkrimi	2015				2016			
	TM1	TM2	TM3	TM4	TM1	TM2	TM3	TM4
Vlera e transaksioneve	320,877,803	394,287,813	484,331,455	528,535,806	507,362,616	625,831,678	730,094,774	694,623,437
prej të cilave:								
1 - ATM tërheqje cash	235,545,213	298,089,166	345,598,943	343,426,095	320,277,380	398,059,598	466,394,534	435,729,780
2 - ATM depozitime	10,493,541	20,875,910	45,521,302	104,537,976	125,437,265	162,224,352	199,089,206	190,486,995
3 - Kredit Transfere nëpërmjet ATM	85,780	89,297	87,981	110,562	84,374	112,384	110,412	159,811
4 - Tërheqje cash në terminale POS	2,124,611	4,165,752	10,282,945	3,783,768	2,780,863	2,803,053	1,362,719	597,737
5 - Pagesa me kartela në terminale POS	72,628,659	71,067,687	82,840,284	76,677,404	58,782,735	62,632,291	63,137,903	67,649,114

Burimi: BQK (2016)

Nga të dhënat në tabelën 10 shihet se tërheqjet në ATM përbëjnë rreth 62.73 përqind të vlerës së përgjithshme të transaksioneve me kartela, pagesat në POS terminale përbëjnë rreth 9.74 përqind, deponimet në ATM 27.4 përqind, ndërsa kredit transferet përmes ATM-ve dhe tërheqjet në POS terminale përbëjnë rreth 0.10 përqind të vlerës së përgjithshme të transaksioneve me kartela.

Figura 18. Pjesëmarrja e transaksioneve me kartela sipas numrit dhe sipas vlerës



Burimi: BQK (2016)

Nga grafiku 19 konstatohet për numrin e vogël të kartelave aktive. Nga grafiku shihet se vetëm 60.29 përqind e kartelave të debitit janë aktive në terminale POS apo ATM, ndërsa sa u përket kartelave të kreditit, rreth 65.82 përqind e tyre janë aktive.

Figura 19. Kartelat aktive



Burimi: BQK (2016)

Përfundim

Bazuar në hulumtimin dhe analizën e raportit të fundit tremujor mbi instrumentet dhe terminalet e pagesave në Kosovë, mund të konstatohet për përmirësim të infrastrukturës së pagesave, rritje të vazhdueshme të numrit të instrumenteve të pagesave dhe njëkohësisht ngritje në përdorimin e këtyre instrumenteve.

Gjatë kësaj periudhe të vlerësimit, vërehet një rritje e përdorimit të instrumenteve elektronike të pagesave, që do të ndikojë në reduktimin e pagesave me para të gatshme. Kjo rritje ka ardhur si rezultat i angazhimit të akterëve kryesorë të sistemit të pagesave për krijimin e kushteve për reduktim të pagesave me para të gatshme.

Trendi i lartë i rritjes së numrit dhe po ashtu përdorimit të instrumenteve të pagesave do të ndikojë në reduktimin e transaksioneve të kryera me para të gatshme. Rritja e mëtejme e përdorimit të instrumenteve për pagesa elektronike, do të zvogëlojë sasinë e parasë së gatshme në qarkullim dhe do të rritë sigurinë dhe efikasitetin në kryerjen e pagesave.

Bazuar në vlerësimet si më lartë, shihet se Kosova ka perspektivë të mirë sa i përket përdorimit të instrumenteve elektronike të pagesave. Mosha mesatare mjaft e re e popullsisë në Kosovë, si dhe niveli i njohurive për teknologjinë e re lejojnë të besohet se pagesat elektronike do të jenë faktorë shumë i rëndësishëm në zvogëlimin e pagesave me para të gatshme, si dhe formave tradicionale të transfereve të bazuar në letër.

Nga të dhënat e paraqitura më lart, mund të konstatohet se ka ende hapësira për përmirësim të politikave dhe mekanizma të tjerë për të rritur përdorimin e instrumenteve të reja elektronike të pagesave në Kosovë.